



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 62

2001

Dhjetor

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Dekret nr. 3196, datë 19.12.2001	Për lejmim lënie të shtetësisë shqiptare..... 1935
Vendim i KM nr. 711, datë 27.12.2001	Për strukturat dhe nivelet e pagave të nëpunësve civilë në institucionet e administratës qendrore, administratës së Presidentit dhe Kuvendit dhe disa shtesa e ndryshime në vendimin nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore", ndryshuar me vendimet nr.39, datë 26.1.2001, nr.158, datë 22.3.2001, nr.167, datë 30.3.2001, nr.174, datë 30.3.2001, nr.197, datë 6.4.2001, nr.358, datë 31.5.2001 dhe nr.424, datë 11.6.2001 të Këshillit të Ministrave..... 1936
Vendim i GJK nr.185, datë 26.11.2001	Me objekt shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.12, datë 7.1.1999 të Këshillit të Ministrave "Për objektet që do të mbeten në administrim të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare". 1939
Kërkesë	Për shpallje të vdekur të Jovan Memës..... 1941
Kërkesë	Për shpallje të zhdukur të Bashkim Gorovelli..... 1941

D E K R E T
Nr. 3169, datë 19.12.2001

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

D E K R E T O J:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Ilia Aleks Kadiqi
2. Ariana Ymer Kadiqi (Seferi)
3. Edlira Ilia Kadiqi
4. Henrik Ilia Kadiqi
5. Alfred Kostandin Qirko
6. Feriz Elez Bisheva
7. Ezmeralda Abaz Eisenhut (Kameraj)
8. Mira Muntaz Hirzel (Kokalari)
9. Fatmir Xhafer Gjasula
10. Klaus Fatmir Gjasula
11. Ina Fatmir Gjasula
12. Jurgen Fatmir Gjasula
13. Dhimitër Spiro Bufi
14. Ermira Hysni Bufi (Brari)
15. Edvin Dhimitër Bufi
16. Aleksandër Dhimitër Bufi
17. Ardjan Jaho Bendfeldt (Karaj)
18. Albana Dhimitraq Kaca (Vllahu)
19. Ira Eduart Kaca
20. Artan Mersin Mema
21. Adrian Isuf Myrteza
22. Natasha Iljaz Diroll (Zharri)
23. Ilir Haxhi Ceka
24. Artur Llazi Dimo
25. Edson Artur Dimo
26. Genti Artur Dimo
27. Diana Napolon Dimo (Qendro)
28. Lindita Musa Rubertus (Guxha)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Rexhep Meidani

V E N D I M
Nr. 711, datë 27.12.2001

**PËR STRUKTURAT DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË NË
INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS QENDRORE, ADMINISTRATËS SË
PRESIDENTIT DHE KUVENDIT DHE DISA SHITESA E NDRYSHIME NË VENDIMIN
NR.726, DATË 21.12.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PAGAT E
PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE”, NDRYSHUAR ME VENDIMET
NR.39, DATË 26.1.2001, NR.158, DATË 22.3.2001, NR.167, DATË 30.3.2001, NR.174,
DATË 30.3.2001, NR.197, DATË 6.4.2001, NR.358, DATË 31.5.2001 DHE NR.424,
DATË 11.6.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 18 e 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe të neneve 2 dhe 6 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, me propozimin e Kryeministrit dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Struktura e pagave dhe nivelet për nëpunësit civilë dhe institucionet e administratës qendrore, administratës së Presidentit dhe Kuvendit janë sipas lidhjet nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Paga e grupit (kolona 2) e lidhjes 1 – Diplomë e shkollës së lartë është 9 000 (nëntë mijë) lekë.

3. Shtesa për vjetërsi pune (kolona 3) jepet në masën 2 për qind pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën e grupit.

4. Shtesa për kualifikim (kolona 4) është 0.

5. Shtesa për pozicion është sipas kolonës 5 të lidhjes nr. 1.

6. Kategorizimi (kolona 1) brenda çdo klase bëhet në përputhje me lidhjen nr.2, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

7. Në vendimin nr. 726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”, ndryshuar me vendimet nr.39, datë 26.1.2001, nr.158, datë 22.3.2001, nr.167, datë 30.3.2001, nr.174, datë 30.3.2001 nr.197, datë 6.4.2001, nr.358, datë 31.5.2001 dhe nr.424, datë 11.6.2001 të Këshillit të Ministrave bëhen këto ndryshime:

a) Nivelet e pagave ekzistuese për emërtesat e mëposhtme, në të gjithë vendimin nr.726, shfuqizohen dhe përcaktohen sipas niveleve, si vijon:

- Drejtor i Kabinetit të Kryeministrit barazohet në pagë me nëpunësin civil të kategorisë I-a.

- Këshilltari i Kryeministrit, Zëdhënësi i Kryeministrit dhe Drejtori i Kabinetit të Zëvendëskryeministrit barazohen në pagë me zëvendësministrin, sipas shornjës “b” më poshtë:

- Ndihmësi i Kryeministrit dhe këshilltari i Zëvendëskryeministrit barazohen në pagë me nëpunësin civil të kategorisë I-b.

- Ndihmësi i Zëvendëskryeministrit dhe shefi i kabinetit të ministrit barazohen në pagë me nëpunësin civil të kategorisë II-a.

- Këshilltari i ministrit dhe zëdhënësi barazohen në pagë me nëpunësin civil të kategorisë II-b.

b) Në lidhjen 1 “Renditja e funksioneve sipas klasifikimit” nivelet e pagave për emërtesat e mëposhtme ndryshohen si më poshtë vijon:

Presidenti 220 000 lekë

Kryeministri, Kryetari i Kuvendit 195 000 lekë

Zëvendëskryeministri, Nënkyetari i Kuvendit 160 000 lekë

Ministri 150 000 lekë

Deputeti 135 000 lekë

Zëvendësministri 117 000 lekë

Sekretar i Kryeministrit, Presidentit, Kryetarit të Kuvendit, Zëvendëskryeministrit, Nënkryetarit të Kuvendit III-b

Sekretar i ministrit, sekretar IV-a

c) Ndryshimet e mësipërme pasqyrohen në lidhjet përkatëse të pagave të Presidencës, të Kuvendit dhe të ministrive.

Këto nivele pagash zbatohen dhe për funksionet ekuivalente të administratës së Presidentit dhe të Kuvendit.

8. Zbatimi i niveleve të pagave për të gjitha kategoritë e përcaktuara nga ky vendim do të bëhet pas përfundimit të kategorizimit të pozicioneve. Kategorizimi të përfundojë 60 ditë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

9. Deri në përfundim të kategorizimit, nëpunësit civilë të institucioneve të administratës qendrore, të administratës së Presidentit dhe Kuvendit të paguhen sipas niveleve të kategorive minimale të pagave të klasës përkatëse.

10. Punonjësit, të cilët në çastin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi kanë nivele pagash më të larta se niveli i përcaktuar në pikën 9 të këtij vendimi, të vazhdojnë të paguhen sipas niveleve ekzistuese të pagave.

11(a) Deri në përfundimin e kategorizimit, shefi i sektorit që ka në varësi një specialist paguhet sipas kategorisë III-b.

Drejtori i drejtorisë që nuk ka sektorë në varësi paguhet sipas kategorisë III-a, Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme që ka në varësi një drejtor paguhet sipas kategorisë II-b.

b) Punonjësit e shkronjës "a" më sipër nuk përfitojnë nga parashikimi i pikës 10 të këtij vendimi.

12. Struktura dhe nivelet e pagave sipas pikave 1-5 të këtij vendimi, zbatohen edhe në funksionet ekuivalente të administratës së Presidentit dhe të Kuvendit.

13. Të gjitha dispozitat në kundërshtim me këtë vendim shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare prej 1 janarit 2001.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

LIDHJA NR. 1

KLASA	KATEGORITË	PAGA MUJORE			SHTESA E POZICIONIT
		PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			
	1	2	3	4	5
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHK)	Shtesa për kualifikim (SHP)	Shtesa për pozicion (SHP) lekë
I	I-a	9 000	2%	0	111 000
	I-b	9 000	2%	0	100 000
II	II-a	9 000	2%	0	90 000
	II-b	9 000	2%	0	74 000
III	III-a	9 000	2%	0	55 000
	III-b	9 000	2%	0	40 000
IV	IV-a	9 000	2%	0	30 000
	IV-b	9 000	2%	0	20 000

LIDHJA NR.2
KLASIFIKIMI I VENDEVE TË PUNËS NË SHËRBIMIN CIVIL

Vendet e punës në Shërbimin Civil grupohen në 4 klasa si më poshtë:

Klasa I: Ka përgjegjësinë për menaxhimin e institucionit, përcaktimin e strategjisë dhe hartimin e politikave të përgjithshme në fushat që mbulon institucioni, koordinimin e këtyre politikave të përgjithshme dhe përdorimin eficient të të gjitha burimeve financiare, njerëzore etj. për arritjen e rezultateve të përcaktuara, si dhe dhënien e këshillimit përfundimtar dhe të drejtpërdrejtë ministrit ose drejtuesit të institucionit.

Në këtë klasë bëjnë pjesë kategoritë:

I-aSekretar i Përgjithshëm

I-bSekretar i Përgjithshëm në Ministri

Drejtor Departamenti në Këshillin e Ministrave

Klasa II: Është nbiveli më i lartë i menaxhimit të një institucioni dhe ka përgjegjësi për hartimin e politikave në një fushë të caktuar dhe për arritjen e rezultateve të përcaktuara në këtë fushë.

II-aDrejtor i Drejtorisë së Përgjithshme

II-bDrejtor drejtorie

Klasa III: Bën të mundur koordinimin e mendimit dhe opsioneve të reja politike për një fushë të caktuar të specialitetit, zbatimin e politikave në këtë nivel, përgatitjen e propozimeve përfundimtare të cilat duhen aprovuar nga niveli menaxhues më i lartë. Kjo klasë bën të mundur gjithashtu dhe zgjidhjen e problemeve komplekse që lidhen me menaxhimin e projekteve të mëdha ose sektorëve/njësive brenda institucionit.

Në këtë klasë bëjnë pjesë kategoritë:

III-aPërgjegjës sektori

III-bPërgjegjës sektori

Specialist i nivelit të lartë

Klasa IV: Kjo klasë merret me zbatimin e politikave ekzistuese, koordinimin e aktiviteteve të stafit mbështetës, si dhe me formulimin dhe vlerësimin e opsioneve politike mbi një fushë të caktuar, duke u bazuar në eksperiencën profesionale të fushës, njohuritë e specialitetit, analizën e informacionit dhe kërkimin.

Në këtë klasë bëjnë pjesë kategoritë:

IV-aSpecialist i nivelit të mesëm

IV-bSpeciali

V E N D I M
Nr.185, datë 26.11.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija VuciAnëtar i	""
Gjergj SauliAnëtar i	""
Alfred KaramuçoAnëtar i	""
Kujtim PutoAnëtar i	""
Kristofor PeçiAnëtar i	""

Sokol SadushiAnëtar i	""
Petrit PllloçiAnëtar i	""
Tefta ZakaAnëtar e	""

me sekretare Arbenka Lalica, në datat 19.10.2001 dhe 29.10.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.151 Akti që i përket:

KËRKUES: SHOQATA KOMBËTARE E TË SHPRONËSUARVE "PRONËSI ME DREJTËSI", përfaqësuar nga avokat Agim Tartari.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KËSHILLI I MINISTRAVE, në mungesë.
2. DREJTORIA E SHËRBIMEVE QEVERTARE, përfaqësuar nga Elsa Myslymi, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.12, datë 7.1.1999 të Këshillit të Ministrave "Për objektet që do të mbeten në administrim të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare".

Kërkuesi, për shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.12, datë 7.1.1999 si të pajtueshëm me Kushtetutën, parashtron këto shkaqe:

-Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.12, datë 7.1.1999 vjen në kundërshtim me Kushtetutën dhe konkretisht me nenin 100/4 të saj, sipas të cilit "aktet e Këshillit të Ministrave janë të vlefshme kur nënshkruhen nga Kryeministri dhe Ministri propozues". Nga Fletorja Zyrtare nuk rezulton që Zëvendëskryeministri dhe Ministri i Koordinimit Qeveritar të ketë nënshkruar këtë vendim.

-Vendimi i Këshillit të ministrave nr.12, datë 7.1.1999 nuk është nxjerrë në bazë e për zbatim të ndonjë ligji të veçantë, në kundërshtim me nenin 118/1 të Kushtetutës, sipas të cilit "aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve...".

-Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.12, datë 7.1.1999 vjen në kundërshtim me parimet e neneve 41 dhe 42 të Kushtetutës.

Në këtë rast ndodhemi para një akti me karakter zhveshës nga e drejta e pronësisë, sepse vendimi nuk parashikon asnjë shpërblim për pronarin dhe nuk merr parasysh të drejtat e tij.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Tefta Zaka, përfaqësuesit e kërkuesit, të subjektit të interesuar, si dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Kërkuesi, Shoqata Kombëtare e të Shpronësuarve "Pronësi me Drejtësi", ka parashtruar se vendimi i Këshillit të Ministrave nr.12, datë 7.1.1999 "Për objektet që do të mbeten në administrim të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare" vjen në kundërshtim me nenet 41, 42, 100/4 dhe 118/1 të Kushtetutës, sepse nuk është nënshkruar nga ministri propozues, nuk ka dalë në bazë e për zbatim të ndonjë ligji të veçantë dhe cenon të drejtën themelore të pronësisë.

Gjithashtu, sipas kërkuesit, objektet e parashikuara në listën bashkëngjitur vendimit të Këshillit të Ministrave i kanë kaluar në administrim Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, duke i mohuar pronarëve të tyre të drejtën e pronësisë dhe duke mos parashikuar asnjë shpërblim për këta pronarë.

Gjykata Kushtetuese, pas shqyrtimit të çështjes, arriti në përfundimin se vendimi i Këshillit të Ministrave nr.12, datë 7.1.1999 "Për objektet që do të mbeten në administrim të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare" është një akt administrativ me karakter individual dhe në kuptim të nenit 131/c të Kushtetutës çështja nuk është në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.

Në bazë të nenit 131 shkronja "c" të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese vendos për pajtueshmërinë e akteve normative të organeve qendrore me Kushtetutën dhe marrëveshjet

ndërkombëtare pra, për akte të cilat vendosin norma të përgjithshme, abstrakte dhe që rregullojnë marrëdhënie të caktuara juridike, që i shtrijnë efektet e tyre mbi një kategori të pacaktuar subjektsh.

Në rastin konkret, vendimi i Këshillit të Ministrave nr.12, datë 7.1.1999 është një akt administrativ me karakter individual, sepse rregullon marrëdhënie konkrete për një çështje të caktuar dhe i shtrin efektet e tij në një kategori të caktuar subjektsh.

Gjithashtu, ky qëndrim harmonizohet dhe me Kodin e Procedurës Civile, në nenin 326 të të cilit parashikohen rastet kur nuk mund të ngrihet padi në gjykatën e zakonshme, duke përfshirë edhe kategorinë e akteve administrative me karakter normativ të Këshillit të Ministrave, si dhe aktet administrative që, sipas Kushtetutës, janë në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131 e 134 të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

KËRKESE (PËR SHPALLJE TË VDEKUR)

KërkuesE: Maria Stavro, e bija e Jovanit, e datëlindjes 1949, lindur në Durrës e banuese në rrugën "Justin Gudari", nr.2, Tiranë.

Objekti: Kërkohet certifikata e vdekjes së Jovan Memës.

Pranë Zyrës së Gjendjes Civile të Bashkisë së Tiranës kërkohet të bëhen ndryshimet e nevojshme në regjistrat themeltarë të saj, duke regjistruar të vdekur të ndjerin Jovan Mema dhe të lëshojë certifikatën e tij të vdekjes, por ajo nuk e bën këtë, duke sugjeruar që të bëhet me vendim gjykatë, pasi ai është evidencuar prej asaj Zyre si i vdekur pa gjeneralitete të plota e të sakta.

**KËRKUESE
Marija Stavro**

KËRKESE (PËR SHPALLJE TË ZHDUKUR)

Kërkuese: Dafina Gorovelli, e bija e Vasilit dhe e Naunkës, lindur në vitin 1959, banuese në Karbunarë Lushnjë.

Objekti: Kërkoj shpalljen të zhdukur të bashkëshortit Bashkim Gorovelli.

Baza ligjore: Nenet 15 e vijues të Kodit Civil.

Unë bashkëshortja e Bashkim Gorvellit nga fshati Karbunarë Lushnjë kam dy fëmijë nga martesat me të. Bashkëshorti im ka rreth katër vjet që është larguar nga shtëpia. Nuk dimë se ku ndodhet. Në këto rrethana, kërkojmë që të shpallet i zhdukur shtetasi Bashkim Aqif Gorovelli.

**KËRKUESE
Dafina Gorovelli**

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 31.12.2001
Doli nga shtypi më 31.12.2001

Tirazhi: 4230 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2001

Çmimi: 150 lekë